

# BULETIN I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE



Maj 2023

Përmbajtja:

- Ngritja e kapaciteteve në fokus të "Balkan CyberSecurity Days"
- Google lancon programin e ri të trajnimit
- Mbrojtja nga sulmet kibernetike dhe rritja e sigurisë për sistemet Industriale
- Patching Alert



## Ngritja e kapaciteteve në fokus të "Balkan CyberSecurity Days"

Në kuadër të objektivave strategjike në terma të ngritjes së kapaciteteve, AKCESK mori pjesë në trajnimin "Balkan Cybersecurity Days" të zhvilluar në Ohër, në datat 16-18 maj.

Qëllimi i trajnimit ishte rritja e kapaciteteve mbi njoftimin dhe mitigimin ndaj sulmeve kibernetike, teknikat me të mira në threat intelligence, mbrojtja nga sulmet DDoS dhe sulmet phishing.

Pjesëmarrja në trajnim i mundëson AKCESK rritjen e kapaciteteve njerëzore në terma të hetimit digjital dhe mbrojtjes së sistemeve nëpërmjet teknikave të avancuara të analizës së sigurisë.



## Google lancon programin e ri të trajnimit

Google ka lancuar programin e ri të trajnimit për analist të sigurisë kibernetike.

Trajnimi është i dobishëm për role të ndryshme analistësh, duke përfshirë SOC, sigurinë e informacionit, sigurinë e IT-së dhe analistin e mbrojtjes kibernetike.

[Link: Lexo më shumë](#)



## Mbrojtja nga sulmet kibernetike dhe rritja e sigurisë për sistemet Industriale

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve teknike të Infrastrukturave Kritike, të cilat funksionojnë mbi Sistemet Industriale, AKCESK mori pjesë në trajnimin ICS 301L të zhvilluar nga "CyberSecurity and Infrastructure Security Agency (CISA)" në Laboratorin Kombëtar të "Departament Homeland Security" në Idaho Falls, USA. Trajnimi, i organizuar në laboratorë me pajisje industriale, i ofron pjesëmarrësve një përvojë reale të sulmeve dhe mënyrës së mbrojtjeve së këtyre sistemeve, të ndarë në ekipe Blue Team dhe Red Team, duke përdorur mjete si Kali Linux dhe Security Onion. Pjesëmarrja aktive në trajnimet e zhvilluara nga CISA i shërben AKCESK për rritjen e kapaciteteve teknike dhe bashkëpunimin në ekip gjatë menaxhimit të një incidenti kibernetik në Sistemet Industriale të Kontrollit.

## PATCHING ALERT



Microsoft ka publikuar versionin e ri Windows 11 22H2 KB5026372, i cili përfshin 20 përditësime bug esh dhe të gjithë përditësimet e *Microsoft Patch Tuesday May 2023*.

AKCESK rekomandon të gjithë përdoruesit e Windows të instalojnë versionin e përditësuar.

[Link: Windows 11 KB5026372 cumulative update released with 20 changes](#)

# BULETIN I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE



## Përmbajtja

- Cybersecurity Leadership Program
- Trajnimi Threat Hunting
- Harmonizimi i kuadrit ligjor me BE, në funksion të forcimit të sigorisë kibernetike në nivel kombëtar
- Vlerësimi i Sigurisë Kibernetike në Sistemet Industriale, ICS 401 L.



### Cybersecurity Leadership Program

Tajnimi intensiv pesë-ditor në Universitetin Duke dhe pranë Microsoft në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mbledhi drejtues të sektorit privat dhe publik, si dhe ekspertë kyç të industrisë në fushën e sigurisë kibernetike.

Fokusi i programit ishte thellimi i njohurive të avancuara për të përballuar sfidat e së nesërme në fushën e sigurisë kibernetike dhe zbutjen e rrezikut ndaj këtyre sulmeve.

Programi i Liderit të Sigurisë Kibernetike konsistonte në tematika të dedikuara që përfshijnë Sigurinë Kibernetike dhe Bordin, Sfidat për CISO, Përgatitjen dhe Reagimin ndaj Shkeljeve të të Dhënave, Impaktin e Incidenteve Kibernetike.



### Trajnimi Threat Hunting

Në kuadër të mbështetjes së Këshillit të Evropës nëpërmjet e-Governance Academy dhe në vijim të aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve të stafeve përgjegjëse, AKCESK në bashkëpunim me Cybexer Technologies, organizuan ushtrimin kibernetik "Threat hunting", me pjesëmarrës nga infrastrukturat kritike të informacionit.

Trajnimi i shërben rritjes së kapaciteteve teknike nëpërmjet ushtrimeve kibernetike, bazuar në Table Top Exercise dhe simulime sipas skenarëve të dedikuara të sulmeve kibernetike që mund të prekin sektorë të ndryshëm të infrastrukturave kritike të informacionit.

Pjesëmarrja aktive në këtë trajnim i shërben AKCESK për rritjen e kapaciteteve teknike në funksion të zgjidhjes së incidenteve kibernetike në Infrastrukturat Kritike të Informacionit.



### Harmonizimi i kuadrit ligjor me BE, në funksion të forcimit të sigorisë kibernetike në nivel kombëtar

Në datat 25-26 Maj, u mbajt në Komisionin Evropian takimi dypalësh për Kapitullin 20 "Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale", në kuadër të procesit të integritimit.

AKCESK, në kuadër të angazhimeve të ndërmarra si vend kandidat për anëtarësim në BE, prezantoi zhvillimet për harmonizimin e kuadrit ligjor të fushës me BE, nëpërmjet projektligjit "Për sigurinë kibernetike", si dhe iniciativën inovative për ngritjen e Akademisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike, e cila synon rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve njerëzore.

Takimi riafirmon qasjen progresive të Qeverisë Shqiptare në terma të harmonizimit të politikave të fushës së sigurisë kibernetike me BE, si dhe prioritetin për forcimin e sigurisë kibernetike, duke shfrytëzuar potencialin e kërkimit shkencor, inovacionit dhe bashkëpunimit me aktorët e fushës.



### Vlerësimi i Sigurisë Kibernetike në Sistemet Industriale, ICS 401 L.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve teknike të Infrastrukturave Kritike, të cilat funksionojnë mbi Sistemet Industriale, AKCESK mori pjesë në trajnimin ICS 401L të zhvilluar nga "CyberSecurity and Infrastructure Security Agency (CISA)" në Laboratorin Kombëtar të "Departament Homeland Security" në Idaho Falls, USA.

Në fokus të këtij trajnimi ishte vlerësimi i Sigurisë Kibernetike në Sistemet Industriale. Gjatë trajnimit pjesëmarrësit u njohën me tool CSET, i cili mundëson kryerjen e vlerësimit të Sigurisë Kibernetike të Sistemeve Industriale të Infrastrukturave Kritike si dhe vlerësimin e implementimit të masave të sigurisë bazuar në standardet më të njohura ndërkombëtare.

Pjesëmarrja aktive në trajnimet e zhvilluara nga CISA i shërben AKCESK për rritjen e kapaciteteve teknike dhe bashkëpunimin në ekip gjatë menaxhimit të një incidenti kibernetik në Sistemet Industriale të Kontrollit.